

I. QARKULLIMI NË SHQIPËRI ME LEJEDREJTIMI TË HUAJA, DHE NJËVLEFSHMËRIA (KONVERTIMI) I TYRE ME LEJEDREJTIMI SHQIPTARE

Të huajt ose vendasit, mbajtës të lejedrejtiveve të huaja ose lejedrejtiveve ndërkombëtare, të lëshuara nga një shtet i huaj, mund të drejtojnë mjete për të cilat lejedrejtimi e tyre është e vlefshme në territorin shqiptar, me kusht që mos jenë banues në Shqipëri për më shumë se një vit.

Mbajtësit e lejedrejtimit, gjatë kohës kur ajo është e vlefshme, të lëshuar nga një shtet i Komunitetit Europian, USA, Canada dhe vendeve që janë palë në konventat dhe marrëveshjet e Kombeve të Bashkuara në fushën e lejedrejtimit, që kanë marrë lejen e banimit në Republikën e Shqipërisë, mund të marrin, me anë të një kërkesë dhe të dorëzimit të lejedrejtimit të sipërpërmendur, një lejedrejtimi të të njëjtës kategori për të cilën është e vlefshme lejedrejtimi i tyre, pa qënë nevoja të japin provimet e aftësisë për drejtues mjete (provën teorike dhe provën e aftësive drejtuese e të sjelljes). Kjo dispozitë është gjithashtu e vlefshme për shtetasit shqiptarë, mbajtës të lejedrejtiveve të vendeve të sipërpërmendura. Lejedrejtimi i zëvendësuar i rikthehet, nga autoriteti shqiptar që ka lëshuar lejedrejtimin e ri, autoritetit të shtetit që e ka lëshuar.

Në rastin e njëvlefshmërisë (konvertimit) së lejedrejtimit, në faqen e pasme të lejedrejtimit, në pjesën e poshtme, fusha 12 horizontal, shënohet kodi 70 në përputhje me kodet e harmonizuara në Aneksin I të Direktivës 2006/126/EC “Mbi lejet e drejtimit”.